



**Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo**

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 4 dhe paragrafit 1.25 të Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në takimin e mbajtur më 10 prill 2019, miraton këtë:

**RREGULLORE NR.03/2019 PËR SHËRBIMIN E KOMUNIKIMIT PUBLIK NË
SISTEMIN PROKURORIAL**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i mënyrës së ofrimit të shërbimit të komunikimit publik dhe i funksionimit të tij aktiv, të qëndrueshëm, unik, si dhe i ngritjes së transparencës dhe koordinimit të plotë për prezantim të drejtë dhe të paanshëm të aktiviteteve dhe veprimtarisë publike të sistemit prokurorial të Kosovës.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Kjo rregullore zbatohet nga të gjithë të punësuarit në sistemin prokurorial.

**Neni 3
Përkufizimet**

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

“KPK” - Këshilli Prokurorial i Kosovës

“PSH” - Prokurori i Shtetit

“ZKPSH” - Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit

“KPSH” - Kryeprokurori i Shtetit

“SKPK” - Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës

“NJSHPP” - Njësiti për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive

“SHKP” - Shërbimi i Komunikimit Publik

"TKKP" - Trupi Koordinues për Komunikim Publik

"SHC" - Shoqëria Civile

"OJQ" - Organizatë Joqeveritare

"MEDIA" - Të gjitha nivelet dhe format private, publike dhe në internet të komunikimit nëpërmjet shtypit, televizionit, radios dhe shërbimeve të internetit.

"RASTET E VEÇANTA" - Raste të ndjeshme, të cilat zgjojnë interesim të madh të publikut

Neni 4

Parimet e komunikimit

1. Parimet standarde të komunikimit publik të sistemit prokurorial janë:

- 1.1 Parimi i komunikimit të drejtpërdrejtë, i cili është transparent dhe llogaridhënës para publikut.
- 1.2 Parimi i komunikimit të tërthortë, i cili është objektiv, i saktë dhe i paanshëm.
- 1.3 Parimi i komunikimit të përmbledhur, i cili është i përgjegjshëm dhe koherent, si siguron pjesëmarrjen e nevojshme publike të informacionit.
- 1.4 Parimi i mosdëmtimit të hetimeve dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
- 1.5 Parimi universal i ndjeshmërisë së komunikimit publik për prezumimin e pafajësisë, privatësisë, lirisë së shprehjes dhe shtypit, barazisë, të drejtës së patjetërsueshme për informim, të drejtës për jetë private dhe dinjitet, si dhe konfidencialitetit të hetimeve dhe
- 1.6 Parimi i përfshirjes së publikut në komunikimin publik, i cili garanton pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në krijimin e politikave përmes komunikimit publik, si e drejtë për të shprehur pikëpamjet qytetare dhe për të komunikuar me vendimmarrësit institucionalë.

Neni 5

Personat përgjegjës për komunikim publik

1. Personat përgjegjës për komunikimin publik në sistemin prokurorial janë:

- 1.1. Kryesuesi i KPK-së;
- 1.2. Kryeprokurori i Shtetit;
- 1.3. Kryeprokurorët e prokurorive;
- 1.4. Udhëheqësi i Trupit Koordinues;
- 1.5. Prokurorët e rasteve;
- 1.6. Drejtori i Sekretariatit të KPK-së;
- 1.7. Drejtori i NJSHPP-së;
- 1.8. Udhëheqësit e zyrave për komunikim publik në Sekretariatit e Këshillit dhe Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe

1.9.Zyrtarët për komunikim publik në prokuroritë e Kosovës.

2. Personat përgjegjës për komunikimin publik në sistemin prokurorial nën paragrafët 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.8 dhe 1.9 të këtij neni janë përgjegjës në kuadër të përgjegjësive të tyre të punës dhe komunikimin publik e bëjnë nën mbikëqyrjen e udhëheqësit të tyre përkatës.

Neni 6

Trupa koordinuese për raste të veçanta

1. Kur rrethanat e caktuara kërkojnë një komunikim publik specifik, themelohet Trupi koordinues për komunikim publik në sistemin prokurorial, përbërja e të cilit është si vijon:

1.1. Udhëheqësi i Trupit Koordinues, i cili caktohet nga Kryeprokurori i Shtetit ose Kryesuesi i Këshillit;

1.2. Kryeprokurori i Prokurorisë përkatëse;

1.3. Prokurori i rastit;

1.4. Udhëheqësit e zyrave për komunikim publik në SKPK dhe ZKPSH.

2. Në rastet kur çështja ka të bëjë me ZKPSH-në, Kryeprokurori i Shtetit mund të themelojë trup koordinues me përbërje të ndryshme nga ajo e caktuar me paragrafin 1.

3. Në rastet kur çështja ka të bëjë me KPK-në, Trupi koordinues themelohet nga Kryesuesi i Këshillit.

4. Përgjegjësitë e Trupit koordinues janë:

4.1. Menaxhimi i rasteve të veçanta në komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm publik;

4.2. Koordinimi i të gjitha aktiviteteve dhe veprimtarive, të cilat kanë të bëjnë me komunikimin publik në raste të veçanta në sistemin prokurorial;

4.3. Mbajtja e takimeve koordinuese deri në përmbylljen e rasteve;

4.4. Hartimi i planit për menaxhimin e rastit dhe raportit përkatës dhe

4.5. Bashkëpunimi me institucionet e tjera, varësisht nga natyra e rasteve.

5. Përgjegjësitë e udhëheqësit të Trupit koordinues janë:

5.1. Udhëheq dhe koordinon Trupin koordinues për raste të veçanta;

- 5.2. Mban të informuar në çdo kohë në raste të veçanta Kryeprokurorin e Shtetit dhe Kryesuesin e KPK-së;
- 5.3. Mban takime koordinuese sipas nevojës dhe
- 5.4. Zhvillon komunikimin publik në emër të Trupit koordinues.

Neni 7

Zyrat për komunikim publik

1. Në kuadër të sistemit prokurorial funksionojnë këto zyra:
 - 1.1. Zyra për Komunikim Publik në KPK dhe
 - 1.2. Zyra për Komunikim Publik në ZKPSH.
2. Zyra për Komunikim Publik në KPK është pikë e kontaktit për publikun dhe burim qendror i informacionit për veprimtarinë e Këshillit.
3. Zyra për Komunikim Publik në KPK e ushtron veprimtarinë e saj në raport me publikun në koordinim të plotë me Kryesuesin dhe Drejtorin e Sekretariatit;
4. Zyra për Komunikim Publik në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit është pikë e kontaktit për publikun dhe burim qendror i informacionit për institucionin e Prokurorit të Shtetit, përkitazi me veprimtarinë e të gjitha prokurorive;
5. Zyra për Komunikim Publik në ZKPSH e ushtron veprimtarinë e saj në raport me publikun në koordinim të plotë me Kryeprokurorin e Shtetit dhe
6. Zyrat për komunikim publik në KPK dhe ZKPSH kanë udhëheqësin dhe zyrtarët për komunikim publik.

Neni 8

Përgjegjësitë dhe detyrat e zyrave për komunikim publik

1. Përgjegjësitë dhe detyrat e zyrave për komunikim publik janë:
 - 1.1. Hartimi dhe dërgimi për media i komunikatave, sqarimeve, reagimeve, deklaratave, raporteve dhe publikimeve të shtypura dhe elektronike;
 - 1.2. Hartimi dhe zbatimi i planit të komunikimit në përputhje me planet e punës së Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit;
 - 1.3. Koordinimi me udhëheqësit e lartë përkatës për organizimin e konferencave për media, debateve dhe prezantimeve audiovizuale publike;

- 1.4. Mirëmbajtja e arkivit të fotografive, videove, shënimeve dhe materialeve të nevojshme për nevojat e qasjes raportuese dhe konsultimit kronologjik të tyre lidhur me aktivitetet e udhëheqësve dhe zyrtarëve të lartë institucionalë;
- 1.5. Nxjerrja e buletineve mujore për aktivitetet dhe veprimtarinë e institucionit përkatës;
- 1.6. Hartimi i udhëzuesve, përmbledhjeve të shkruara, kodit etik të zyrtarëve për komunikim publik dhe rregullave ligjore për fushën e komunikimit publik;
- 1.7. Mirëmbajtja e portalit zyrtar;
- 1.8. Ofrimi i ndihmës profesionale për hartimin e strategjisë së shërbimit të komunikimit publik;
- 1.9. Monitorimi i mediave;
- 1.10. Menaxhimi i vazhdueshëm i adresave elektronike zyrtare, ku adresohen të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe mediave dhe
- 1.11. Ofrimi i përkrahjes profesionale për Kryesuesin e Këshillit, Kryeprokurorin e Shtetit, kryesuesit e komisioneve të përhershme të KPK-së, kryeprokurorët e prokurorive, udhëheqësin e Trupit koordinues, prokurorët e rasteve, drejtorin e Sekretariatit dhe drejtorin e NJSHPP-së.

Neni 9

Detyrat e udhëheqësve të zyrave për komunikim publik

1. Detyrat e udhëheqësve të zyrave për komunikim publik janë:
 - 1.1. Udhëheqin zyrën përkatëse të komunikimit publik;
 - 1.2. Sigurojnë qasje dhe transparencë të punës duke bërë ofrimin e informacioneve për opinionin publik, përmes zbatimit të përmbajtjes së ëës informative;
 - 1.3. Sigurojnë që udhëheqësit e lartë institucionalë marrin këshilla të koordinuara, sugjerime, rekomandime dhe përkrahje profesionale për përmirësimin e fushës së komunikimit publik;
 - 1.4. Bashkëkoordinojnë punën e zyrtarëve për komunikim publik në aspektin e zhvillimit profesional;
 - 1.5. Hartojnë dhe ofrojnë ndihmë për përpilimin e dokumenteve profesionale nga fushëveprimtaria e komunikimit publik;
 - 1.6. Bashkërendojnë ndërlidhjen e kontakteve me mediat vendëse dhe ndërkombëtare;

1.7. Marrin pjesë në takimet protokollare sipas kërkesave të Kryesuesit të Këshillit, Kryeprokurorit të Shtetit, kryeprokurorëve të prokurorive, Drejtorit të Sekretariatit dhe Drejtorit të NJSHPP-së, si dhe në takime të tjera sipas nevojës, duke përfshirë takimet e përfaqësimit zyrtar dhe gjatë shkëmbimit të vizitave zyrtare brenda dhe jashtë vendit dhe

1.8. Përgatisin njoftime të ndryshme për publikun me shkrim dhe prononcimin audiovizuel.

Neni 10

Zyrtarët për komunikim publik në prokuroritë e Kosovës

1. Prokuroria e Apelit, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës dhe prokuroritë themelore kanë zyrtarët për komunikim publik.
2. Zyrtarët për komunikim publik ushtrojnë veprimtarinë e tyre në raport me publikun në koordinim të plotë me kryeprokurorin e prokurorisë përkatëse, prokurorin përkatës të çështjes dhe udhëheqësin e Zyrës për Komunikim Publik në ZKPSH.
3. Zyrtarët për komunikim publik në prokuroritë e vendit përgatisin njoftime me shkrim për publikun dhe prononcimin audiovizuel.
4. Përveç zyrtarëve për komunikim publik, me mediat dhe publikun mund të komunikojnë edhe prokurorët e shtetit, në rastet kur kërkohen përgjigje për çështje që nuk pengojnë një proces hetimor.

Neni 11

Përgjegjësitë për komunikimin publik

1. KPK-ja dhe PSH-ja kanë obligim që të ofrojnë informacion në kohë, në lidhje me çështjet që janë me interes për publikun.
2. Kryeprokurori i prokurorisë përkatëse, prokurori i çështjes, administratori, apo cilado zyrë kompetente nga administrata e KPK-së apo e prokurorive janë të obliguar që të bashkëpunojnë ngushtë dhe në afatin sa më të shkurtër kohor t'i ofrojnë të gjitha informatat që mund të bëhen publike te personat përgjegjës për komunikim publik;
3. Zyrat për komunikim publik janë të obliguara që në pajtim me ligjet në fuqi, të përgjigjen në pyetjet e mediave dhe personave të tjerë të interesuar që kanë të bëjnë me një ngjarje aktuale dhe
4. KPK-ja dhe PSH-ja, drejtpërdrejt, apo përmes zyrave për komunikim publik, reagojnë kur në media apo diku tjetër plasohet një informacion i padrejtë, subjektiv, joreal, i

njëanshëm dhe tendencioz, i cili mund të dëmtojë interesin e përgjithshëm të sistemit prokurorial, integritetin profesional të prokurorëve të shtetit apo anëtarëve të KPK-së

Neni 12

Faqja zyrtare e sistemit prokurorial

1. Sistemi prokurorial do të ketë vetëm një portal unik, në të cilin janë të integruara të gjitha institucionet dhe mekanizmat e këtij sistemi;
2. Portali përditësohet dhe mirëmbahet nga udhëheqësit dhe zyrtarët e zyrave të komunikimit publik në KPK dhe ZKPSH, si dhe nga zyrtarët e komunikimit publik në prokuroritë përkatëse.
3. Në portalin e sistemit prokurorial publikohen të gjitha dokumentet dhe materialet e shkruara dhe audiovizuale të KPK-së dhe PSH-së në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 13

Komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm

1. Komunikimi i brendshëm në kuptim të kësaj rregulloreje përcaktohet si:
 - 1.1. Detyrim i secilit zyrtar në kuadër të përgjegjësive të tyre në sistemin prokurorial, të cilat rrjedhin nga aktet ligjore dhe nënligjore për të komunikuar me zyrtarët për komunikim publik, si dhe është detyrim për personat e punësuar në sistemin prokurorial që t'i përmbahen formës së organizuar, të strukturuar dhe të përshtatshme për nivelin e institucionit.
 - 1.2. Mjet për komunikim të brendshëm, që nënkupton mbledhjet institucionale, buletinet, njoftimet e procedimeve të rëndësishme, njoftimet e ndryshimeve në personel, revistave, tabelave të lajmërimeve dhe shpalljeve, qarkoreve, Intranetit, adresave elektronike, blogjeve dhe komunikatorëve.
2. Komunikimi i jashtëm bëhet me qëllim të:
 - 2.1. Zhvillimit të komunikimit publik për të forcuar besimin dhe për të mirëmbajtur perceptimin pozitiv, duke informuar opinionin për veprimtarinë, aktivitetet dhe funksionet e sistemit prokurorial, përmes metodave të komunikimit të jashtëm, të cilat përfshijnë pakon informative dhe

- 2.2. Sigurimit që përmbajtja e komunikimit të brendshëm është e përshtatshme me parimet dhe rregullat e komunikimit publik, ngaqë komunikimi i jashtëm është specifik dhe shumëdimensional.

Neni 14

Raporti njëzetekatër (24) orësh për zhvillimin e veprimtarisë prokuroriale

1. Obligohen të gjitha instancat prokuroriale që të sigurojnë të dhënat e specifikuar në paragrafin 3 të këtij neni dhe t'i dërgojnë ato te zyrtarët për komunikim publik për përpilimin e raportit njëzetekatër (24) orësh për zhvillimin e veprimtarisë së të gjitha prokurorive.
2. Obligohen të gjitha shkrimoret e prokurorive që t'ua përcjellin zyrtarëve për komunikim publik të gjitha informatat e nevojshme, të cilat duhet të dërgohen në Zyrën për Komunikim Publik në ZKPSH, e cila pastaj i dërgon për media.
3. Raporti njëzetekatër (24) orësh duhet të përmbajë të dhënat lidhur me:
 - 3.1. Ndalimet e personave me urdhër të prokurorit;
 - 3.2. Kërkesat për caktimin e paraburgimit;
 - 3.3. Kërkesat për arrestim, përfshirë edhe ato ndërkombëtare;
 - 3.4. Bastisjet;
 - 3.5. Sekuestrimet e përkohshme;
 - 3.6. Numrin e aktakuzave të ngritura me theks të veçantë për keqpërdorim të detyrës zyrtare;
 - 3.7. Informatat relevante për veprimet prokuroriale dhe vendimet përcjellëse të gjykatave që paraqesin rezultatin e prokurorisë dhe
 - 3.8. Rastet e tjera me interes për publikun.
4. Zyrtarët për komunikim publik hartojnë raportin mujor bazuar në raportet 24 orësh.

Neni 15

Kufizimet për dhënien e informatave

1. Personat përgjegjës për komunikim publik duhet të rezervohen nga dhënia e informacioneve për ndonjë çështje, nëse për një gjë të tillë ka bazë ligjore apo duhet të ruhet konfidencialiteti për ndonjë proces hetimor të hapur, me qëllim që të mos cenohet procesi penal.

2. KPK-ja, ZKPSH-ja dhe prokuroritë mund të rezervohen nga dhënia e informacioneve për mediat dhe publikun e gjerë bazuar në legjislacionin e Kosovës dhe standardet ndërkombëtare, në rrethanat kur:
 - 2.1. Informacioni vë në rrezik një hetim apo ndjekje penale;
 - 2.2. Informacioni dëmton integritetin, dinjitetin, sigurinë ose të drejtën për privatësi të kujtqdo;
 - 2.3. Informacioni që kërkohet është i klasifikuar sipas legjislacionit në fuqi;
 - 2.4. Informacioni zbulon identitetin e një viktime;
 - 2.5. Informacioni shkel të drejtat e njeriut;
 - 2.6. Informacioni shkel të drejtat e të miturve dhe
 - 2.7. Informacioni cenon sigurinë kombëtare dhe rendin kushtetues.
3. Personat për komunikim publik gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre duhet të zbatojnë legjislacionin në fuqi, si dhe kodet e etikës.

Neni 16

Procedurat për koordinimin e komunikimit publik

1. Për ta bërë komunikimin publik të lehtë dhe efektiv, prokurorët e rastit dhe zyrtarët për komunikim publik obligohen të sigurojnë që:
 - 1.1. Për rastet të veçanta, të cilat janë me interes për opinionin publik, njoftohet kryeprokurori i prokurorisë përkatëse, i cili para daljes së informacionit në publik, njofton Kryeprokurorin e Shtetit, kurse në rastin kur mund të ndërlihdhet Këshilli, njoftohet Kryesuesi para daljes së informacionit në publik;
 - 1.2. Zyrtarët për komunikim publik duhet të trajtojnë kërkesat e mediave dhe duhet të jenë të informuar për kërkesat e mediave për intervista, artikuj të hollësishëm ose çështje që kanë të bëjnë për sistemin prokurorial;
 - 1.3. Të gjithë përfaqësuesit e mediave, pa dallim, trajtohen njëjtë, me mirësjellje profesionale, duke marrë në konsideratë afatet dhe kufizimet e tyre;
 - 1.4. Personat përgjegjës për komunikim publik kur konsiderojnë se është e nevojshme mbajtja e konferencave për media, rekomandojnë mbajtjen e saj dhe koordinojnë paraprakisht këtë ngjarje;
 - 1.5. Lajmet dhe artikujt e ndryshëm në media, të cilët kanë të bëjnë me informacione për tërë sistemin prokurorial, apo edhe ku është i lakuar emri i ndonjë zyrtari që punon në sistemin prokurorial, duhet të kalohen sa më shpejt të jetë e mundur te personat kompetentë;
 - 1.6. KPK-ja dhe PSH-ja japin informacione për rastet që kanë arritur publicitet të konsiderueshëm, ose për të cilat publiku duhet të sigurohet se autoritetet e duhura po e hetojnë rastin, ose kur publikimi i informacionit është i nevojshëm për të mbrojtur interesin apo mirëqenien e publikut.

Neni 17
Përgjegjësia disiplinore

1. Mosrespektimi i kësaj rregulloreje mund të jetë bazë për fillimin e procedurës disiplinore nëse e njëjta nuk përbën vepër penale.
2. Procedura disiplinore për këto raste zhvillohet duke u zbatuar Ligji për Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nëse prokurorët bëjnë shkelje, ndërsa Ligji për Zyrtarët Publikë, në rast të shkeljeve nga e ana e shërbyesve civilë.

Neni 19
Dispozitat përfundimtare

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja nr. 06/2016 për komunikim publik, e datës 27 maj 2016, si dhe Vendimi për caktimin e prokurorëve përgjegjës për media, i datës 14 qershor 2018.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 maj 2019.

Prishtinë, më 10.04.2019

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial
Bahri Hyseni

